



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 76 prot.

Pukë, më 14 . 01 . 2025

VENDIM

Nr. 5, datë 14/01 /2025

**Për miratimin dhe zbatimin e rregullores "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike dhe deklarimin e pasurive në Bashkinë Pukë"**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikes në Administratën Publike", Ligji Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", Ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar; Ligjit nr.9367 datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike"; Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit";

**Arsyetim:** Me qëllim forcimin e integritetit institucional, parandalimin e konfliktit të interesit, rritjen e transparencës në ushtrimin e funksioneve publike dhe garantimin e standardeve të larta të etikës dhe përgjegjshmërisë në administratën e Bashkisë Pukë, është e nevojshme miratimi i një rregulloreje të posaçme që përcakton rregullat, procedurat dhe përgjegjësitë përkatëse në këtë fushë, **Kryetari i Bashkisë:**

**VENDOSI:**

1. Të miratohet Rregullorja "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike dhe deklarimin e pasurive në Bashkinë Pukë", bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. "Rregullorja" është e detyrueshme për zbatim nga të gjithë zyrtarët dhe punonjësit e Bashkisë Pukë, si dhe nga strukturat në varësi të saj.
3. Autoritet përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje është Kryetari i Bashkisë Pukë. Për zbatimin praktik të saj, ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve, e cila:
  - administron deklaratimet dhe dokumentacionin;
  - mban regjistrat përkatës;
  - kryen verifikime dhe propozon masa;
  - koordinon zbatimin e procedurave dhe formularëve të miratuar.
4. Ky vendim dhe rregullorja publikohen në web-in zyrtar të Bashkisë Pukë dhe u bëhen të njohura të gjithë punonjësve.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
Rrok DODAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 70/ Prot.

Pukë, më 14.01.2025

**RREGULLORE**

“Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike dhe deklarimin e pasurive në Bashkinë Pukë”

*Miratuar me Vendimin nr. 5, datë 14.01.2025 të Kryetarit të  
Bashkisë Pukë, Z. Rrok Dodaj*

## **KREUI**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

##### **Baza ligjore**

Kjo rregullore bazohet në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”;
- Aktet nënligjore përkatëse dhe rregulloren e brendshme të Bashkisë Pukë.

#### **Neni 2**

##### **Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim:

- garantimin e paanshmërisë dhe transparencës në vendimmarrje;
- parandalimin dhe trajtimin e konfliktit të interesave;
- përcaktimin e rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurive;
- forcimin e integritetit institucional.

#### **Neni 3**

##### **Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:

- rregullave dhe procedurave për deklarimin e interesave;
- mënyrave të identifikimit dhe trajtimit të konfliktit të interesit;
- përgjegjësiwe institucionale dhe individuale.

#### **Neni 4**

##### **Përkufizime**

1. “Zyrtar” – çdo punonjës ose funksionar i Bashkisë Pukë.
2. “Person i lidhur” – sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9367/2005.
3. “Konflikt interesi” – çdo situatë ku interesi privat ndikon ose mund të ndikojë në ushtrimin e detyrës.

## Neni 5

### Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për:

- të gjithë zyrtarët e Bashkisë Pukë;
- çdo proces vendimmarrjeje;
- personat e lidhur me zyrtarët.

## Neni 6

### Vendimmarrja

Vendimmarrje konsiderohet:

- akti përfundimtar;
- çdo fazë paraprake që ndikon në përmbajtjen e tij.

## Neni 7

### Kompetenca në vendimmarrje

Zyrtari konsiderohet me rol vendimtar kur ndikon në përmbajtjen e aktit dhe detyrohet të deklarojë interesat private.

## Neni 8

### Interesat private

Interesat private përfshijnë:

- pasuritë dhe detyrimet financiare;
- marrëdhëniet juridike;
- dhuratat dhe përfitimet;
- marrëdhëniet familjare dhe shoqërore;
- çdo interes tjetër që mund të krijojë konflikt.

## KREU II

### IDENTIFIKIMI DHE REGJISTRIMI I KONFLIKTIT TË INTERESAVE

## Neni 9

### Deklarimi rast pas rasti

Çdo zyrtar detyrohet të deklarojë paraprakisht interesat private që mund të krijojnë konflikt interesi.

---

## Neni 10

### Identifikimi nga palë të treta

Çdo person ka të drejtë të informojë për raste të konfliktit të interesit.

## Neni 11

### Autorizimi

Zyrtarët janë të detyruar të japin autorizim për verifikimin e interesave të tyre.

## Neni 12

### Autoriteti përgjegjës

Autoritet përgjegjës është:

- Kryetari i Bashkisë;
- Struktura e caktuar me urdhër përkatës.

## Neni 13

### Detyrat e autoritetit përgjegjës

Autoriteti:

- mbledh dhe administron deklaratimet;
- krijon regjistrin e konflikteve;
- informon ILDKPKI;
- trajnon dhe këshillon zyrtarët;
- propozon masa disiplinore.

## Neni 14

### Regjistri i konfliktit të interesave

Krijohet dhe administrohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

## Neni 15

### Administrimi i dokumentacionit

Dokumentacioni është zyrtar dhe administrohet sipas rregullave të arkivimit.

---

## Neni 16

### Regjistrimi i rasteve

Regjistrohen:

- identiteti i zyrtarit;
- interesi privat;
- vendimi i marrë;
- mënyra e trajtimit.

## KREU III

### DEKLARIMI PERIODIK

## Neni 17

### Subjektet deklaruese

Subjekt kryesor është Kryetari i Bashkisë dhe çdo zyrtar sipas ligjit.

## Neni 18

### Llojet e deklarimit

Deklarohen pasuritë dhe detyrimet sipas ligjit nr. 9049/2003.

## Neni 19

### Kufizimet për zyrtarët

Kryetari i Bashkisë:

- nuk mund të ushtrojë funksione të tjera publike;
- nuk mund të ushtrojë veprimtari fitimprurëse (përveç mësimdhënies);
- nuk mund të ketë aksione aktive në shoqëri tregtare.

## Neni 20

### Personat e lidhur

Kufizimet zbatohen edhe për personat e lidhur me zyrtarin.

**KREU IV**

**MASAT DHE GARANCITË**

**Neni 21**

**Mbrojtja e informuesve**

Sigurohet mbrojtje për çdo person që raporton konflikt interesi.

**Neni 22**

**Ndalimi i dhuratave**

Ndalohet pranimi i dhuratave që lidhen me ushtrimin e detyrës.

**Neni 23**

**Zgjidhja e konfliktit të interesit**

Bëhet sipas ligjit nr. 9367/2005.

**Neni 24**

**Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës**

Asnjë dispozitë nuk mund të përdoret për shmangie të ligjit.

**Neni 25**

**Njoftimi dhe publikimi**

Rregullorja u bëhet e njohur të gjithë punonjësve dhe publikohet në faqen zyrtare.

**Neni 26**

**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

**KRYETARI I BASHKISË**

Rrok Doda

